



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 266 Dt. 09.02.2024

**PLANI I PUNËS PËR VITIN 2024
ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË**

Janar 2024

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/515516 – lokali 1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

Hyrje

Plani Vjetor i Punës për Zyrën për Sigurim të Cilësisë (ZSC) është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 08/L-110 për Agjensionin e Kosovës për Akreditim, Statutin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM), Planin Strategjik për zhvillimin e UIBM për vitet 2022-2025, Udhëzimin Administrativ nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UIBM, rregulloren për sigurim të cilësisë të aprovuar nga Këshilli Drejtues i UIBM, si dhe akte tjera të aprovuara në universitet. Planifikimi për vitin 2024 është kryer në kontekstin e përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit në mësimdhënie, hulumtim, dhe administrim në tërë universitetin.

Plani vjetor i punës për Zyrën për Sigurim të Cilësisë është plan i cili përcakton, objektivat, aktivitetet, bartësit dhe afatet për realizimin e aktiviteteve.

Misioni i Zyrës për Sigurim të Cilësisë

Misioni i Zyrës për Sigurim të Cilësisë (ZSC) është të sigurojë një nivel të lartë të cilësisë në të gjitha fushat: mësimdhënie, mësimnxënie, programe studimore, hulumtim dhe shërbime tjera të ofruara për student, komunitetin lokal dhe atë të biznesit. Misioni i ZSC është në harmoni me misionin e institucionit i cili përmes realizimit të objektivave, jetëson vizionin e universitetit për të qenë institucion prestigjioz në vend dhe rajon, që për qëllim ka përgatitjen e kadrove të cilat janë në harmoni me kërkesat e tregut që do të kontribuojnë në zhvillim të komunitetit lokal dhe rajon në fushat specifike të studimit.

Zyra për sigurimin e cilësisë e UIBM është zyrë e pavarur, e cila drejtpërdrejt i raporton Rektorit të UIBM. Kjo zyrë angazhohet në ngritjen e cilësisë në UIBM, duke zbatuar të gjithë politikën institucionale.

Hartimi i Planit vjetor të punës për vitin 2024 është i bazuar në dokumentet:

1. Ligjin nr.08/L-110 për Agjensionin e Kosovës për Akreditim
2. Udhëzimin Administrativ nr.15/2018 për Akreditimin të IAL të Republikës së Kosovës.
3. Statutin e UIBM
4. Planin Strategjik për UIBM për vitet 2022/2025



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

5. Rregulloren për Organizimin të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UIBM
6. Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë për UIBM të aprovuar nga KD.
7. Rregulloren mbi punës e KQSCV të aprovuar nga KQSCV
8. Udhëzuesin për sigurinë e cilësisë të aprovuar nga Senati i UIBM,

Përgjegjësitë e Zyrës për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për sigurimin e cilësisë është zyrë e pavarur e cila është përgjegjëse për ngritjen e cilësisë përmes të gjitha instrumenteve të paketës së instrumenteve të aprovuara nga UIBM, mbikëqyrë dhe ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të kontrollit të cilësisë përmes metodave-veprimeve të drejta dhe të përshtatshme. ZSC bënë planifikimin, realizimin, mbikëqyrjen/kontrollon dhe zbatim të veprimeve të bazuar në planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve.

ZSC, bazuar në rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në UIBM sipas përgjegjësisë është zyrë e pavarur dhe i përgjigjet Rektorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZSC janë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe përfshijnë:

1. Zbaton procedura të cilat përfshijnë proceset dhe sistemin e vlerësimit;
2. Mbikëqyrë dhe ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të kontrollit të cilësisë përmes metodave-veprimeve të drejta dhe të përshtatshme;
3. Rishikon efikasitetin e sistemit të cilësisë dhe ofron përkrahje profesionale për KQSCV-në lidhur me procedurat e vlerësimit dhe hartimit të llojeve të ndryshme të pyetësorëve në UIBM dhe Fakultetet e UIBM;
4. Ndërmerr veprime për vlerësimin sigurimit të cilësisë së programeve studimore dhe trajnuese, në bashkëpunim me menaxhmentin e fakultetit dhe zyrtaret përkatës të fakulteteve, me qëllim të arritjes së objektivave dhe kontrollit të cilësisë;
5. Bashkëpunon me akterët relevantë në UIBM dhe fakultete në të gjitha fazat e veprimit për implementimin e sistemit të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë;
6. Koordinon dhe realizon aktivitete në lidhje me vetëvlerësimin e institucionit;
7. Merret me përcaktimin e pikëve të kredive të fituara nga pjesëmarrësit në bazë të kritereve të përcaktuara, varësisht nga institucioni në të cilin aplikohet;



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

8. Përgatit raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për akreditim sipas legjislacionit në fuqi.

Objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2024 do të jetë pikë referimi për realizimin e qëllimeve për të përmbushur objektivin parësor për një zyre të përgjegjshme, efektive dhe llogaridhënëse.

Objektivi 1: PLANI VJETOR I PUNËS			
Objektivi specifik	Aktivitetet	Bartësi i aktivitetit	Afati i realizimit
1.1. Analiza dhe hartimi i raportit vjetor të punës për vitin 2023	-Analiza e planit të punës për vitin 2023 në nivel të zyrës -Hartimi i raportit vjetor të punës për vitin 2023 -Analiza e pikave të forta dhe dobësive	Përgjegjësit e ZSC	TM1
1.2 Hartimi i planit të punës për vitin 2024	- Bashkërenditja e propozimeve nga përgjegjësit e fushave - Analiza e draftit final - Hartimi dhe aprovimi i planit të punës për vitin 2024 nga KQSCV	Rektorja KQSCV ZSC	TM1
1.3. Zbatimi, mbikëqyrja, vlerësimi dhe raportimi	- Dinamika e realizimit dhe vlerësimi i performancës - Raportimi në baza mujore, periodike dhe vjetore	ZSC	TM1-TM4

Objektivi 2: AVANCIMI I SIGURIMIT TË CILËSISË SË BRENDSHME			
Objektivi specifik	Aktivitete	Bartësit e	Afatet e



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

-		aktivitetit	realizimit
2.1. Rishikimi i rregullores për sigurim të cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi i kalendarit për aplikim të akreditim dhe ri/akreditimit të programeve të studimit për njësi akademike. - Organizimi i takimeve të punës së bashku me KQSCV-në - Mbledhja e rekomandimeve - Shqyrtimi dhe aprovim në Këshillin Drejtues 	Rektroja KQSCV ZSC	TM1 TM1-TM4 TM1
2.2. Plotësim - Ndryshimi i udhëzuesit për cilësi	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i grupit punues - Organizimi i takimeve të punës - Mbledhja e rekomandimeve - Aprovimi i udhëzuesit në KQSCV 	KQSCV ZSC	TM4
2.3. Rishikimi i paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Analizimi i paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë. - Analizimi i rekomandimeve dhe aprovimi në KQSCV. - Publikimi i paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë në ueb. 	NJA ZSC KQSCV	TM1
2.4. Sistemi antiplagjiat në autorësi të universitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i softuerit për antiplagjiat - Sesioni informues për aplikimin e sistemit antiplagjiat. - Monitorimi i aplikimit të sistemit antiplagjiat nga ana e personelit akademik dhe studentëve 	ZTI ZBF ZSC	TM1
2.5. Avancimi i sistemit elektronik për vlerësimin e cilësisë/ SEVC-it	<ul style="list-style-type: none"> - Hulumtimi dhe evidentimi i mangësive në sistem. - Krijimi i moduleve sipas kërkesave të ZSC-së. - Sesion informues për stafin akademik dhe studentëve për ndryshimet në SEVC 	ZTI ZSC	TM2-TM4

Objektivi 3:
VLERËSIMI I JASHTËM I CILËSISË -AKREDITIMI

Objektivi specifik	Aktivitetet	Bartësit e	Afati i
--------------------	-------------	------------	---------



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

		aktivitetit	realizimit
3.1. Ligjit nr.08/L-110 për Agjensionin e Kosovës për Akreditim dhe zbatimi i tij.	<ul style="list-style-type: none">-Sesioni informues lidhur me aplikimin e Ligjit për Agjensionin e Kosovës për Akreditim.-Rishikimi i kalendarit për procesin e akreditimit dhe riakreditimit të programeve të studimit të njësive akademike.-Aprovimi i kalendarit për aplikim për riakreditim të programeve të studimit.	Rektorja KQZSCV ZSC	TM1
3.2. Akreditimi dhe riakreditimi i programeve të studimit të njësive akademike	<ul style="list-style-type: none">- Procesi i plotësimit të dokumentacionit për riakreditimit të programeve të studimit.-Aktivitetet në plotësimin e kërkesave të AKA lidhur me riakreditimit për programet e dorëzuara të njësive akademike.-Procesi i dorëzimit të ankesave në AKA lidhur me plotësimin e kërkesave për bartësit e programeve.- Procedimi i raporteve të vetëvlerësimit për programet për riakreditim të njësive akademike.	NJA ZSC	TM1
3.3. Aplikimi për programe të reja të studimit për njësi akademike.	<ul style="list-style-type: none">- Procedimi i kërkesave për akreditim për programe të reja dhe pasqyrimi i bartësve të programit.- Informimi i njësive akademike lidhur me vendimin e AKA për plotësimin e kushteve fillestare për akreditim.-Shqyrtimi i kërkesave të AKA lidhur me mosplotësimin e kërkesave për bartësit e programeve.	NJA ZSC	TM2
3.4. Vlerësimi, organizimi i procesit të vetëvlerësimit nga ana e ekspertëve të jashtëm të angazhuar nga AKA.	<ul style="list-style-type: none">- Informimi për njësitë akademike për procesin e vetëvlerësimit.-Koordinimi me njësitë akademike lidhur me organizimin e procesit të	ZSC NJA	TM1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

	vetëvlerësimit. -Zbatimi i kërkesave për procesin e vetëvlerësimit nga ana e ekspertëve të jashtëm dhe përgjegjësve të AKA. -Procedimi i draft vendimit lidhur me të gjeturat e ekspertëve të jashtëm dhe afati për dhënien e komenteve. -Procedimi i vendimit të ekspertëve dhe hartimi i planit për plotësimin e rekomandimeve nga ana e programeve të studimit të njësive akademike.	ZSC NJA ZSC NJA ZSC	TM1 TM1 TM1/TM2 TM2
3.5.Hartimi i Manualit të procedurave për monitorimin e Planit të zbatimit të rekomandimeve.	- Sesioni informues lidhur me manualin për njësi akademike dhe bartësit e programeve të studimeve. -Hartimi dhe implementimi i planit të zbatimit të rekomandimeve.	KQZSCV ZSC	TM3

Objektivi 4
Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë në UIBM.

Objektivi specifik	Aktivitetet	Bartësitë e aktivitetit	Afati i realizimit
4.1. Vlerësimi i studentëve	- Pyetësi me studentët Bachelor - Pyetësi me studentët Master - Pyetësi për vlerësimin e programit të studimeve - Pyetësi për vlerësimin e shërbimeve në UIBM. - Hartimi dhe publikimi i raporteve	ZSC	TM1 -TM2 TM1-TM4 TM1/TM4 TM2 TM2
4.2. Vlerësimi i stafit akademik	- Pyetësi për vlerësimin e shërbimeve në UIBM - Pyetësi për vlerësimin e punës e Dekanëve - Pyetësi për vetëvlerësimin e stafit	ZSC	TM2 TM1/TM2 TM2



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

	performancës		
5.4 Zhvillimi i instrumenteve të reja të cilësisë	- Hulumtimi për instrumente të reja të vlerësimit të cilësisë. - Zbatimi i instrumenteve të reja të vlerësimit.	ZSC	TM2-TM4

Objektivi 6: Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për cilësi			
Objektivi specifik	Aktivitetet	Bartësit e aktivitetit	Afati i realizimit
6.1. Përgatitja për anëtarësim në Asociacionin e Universiteteve Evropiane - EUA	- Mbledhja e informatave për anëtarësim në EUA - Përgatitja e raportit vlerësues mbi rëndësinë dhe nevojën e anëtarësimit në EUA - Krijimi i grupit punues për anëtarësim - Përgatitja e dokumentacioneve dhe procedurave të tjera për anëtarësim nëse vlerësohet nga menaxhmenti.	ZSC	TM1-TM4
6.2. Përgatitja për anëtarësim në Unionin e Studentëve European	- Mbledhja e informatave për anëtarësim në USE - Përgatitja e raportit vlerësues mbi rëndësinë dhe nevojën e anëtarësimit në USE. - Krijimi i grupit punues për anëtarësim nëse vlerësohet nga menaxhmenti.	ZSC	TM1-TM4
4.3. Bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare që merren me	- Hulumtimi i organizatave që merren me fushën e cilësisë në arsimin e lartë.	ZSC	TM2-TM4



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

cilësi në arsimin e lartë.	- Kontakti me organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe krijimi i bashkëpunimit.		
----------------------------	---	--	--

TM1 – Tremujori i parë
TM2 – Tremujori i dytë
TM3 – Tremujori i tretë
TM4 – Tremujori i katërt

Përveç objektivave të lartcekura, Zyra do të sigurojë zbatimin e të gjitha procedurave, detyrave dhe përgjegjësi të tjera të parapara.

Natyra Misini

Zyrtare e lartë për sigurim të cilësisë

Orgesta Mehmeti

Zyrtare e lartë për zhvillim të kurrikulit dhe ECTS